

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-20-5348-5-2-1
Nr i brendshëm	626-20-026-521

Sa i përket tenderit për

“NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË-FAZA E PARË
NDËRTIMI I VRAZHDËT”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“AL-BER” SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Peçan-Suharekë

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

044389813

(Numri Telefonit)

23000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Faton Gashi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

al-ber01@hotmail.co

(Adresa elektronike)

02.11.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë është publikuar në platformën elektronike me datë 18.09.2020. Njoftimi B58, vendimi për dhënie të kontratës është publikuar me datë 27.10.2020. Afati i furnid për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë 02.10.2020 deri në ora 14:00. Hapja e tenderi është bërë me datë 02.10.2020. Kriteri për dhënien e kontratës ka qenë “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit. Konsiderojmë që hapja është bërë me rregull pasi që në datën e njejtë të hapjes kemi pranuar procesverbalin i hapjes. Nuk kemi pasur vërejtje sa i përket hapjes së tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Me datë 27.10.2020, Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës me të cilin na ka dërguar edhe letrën standarde si tenderuesi i pa suksesshëm.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Mendojmë që Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit ka shkelur dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik si dhe dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit si më poshtë:

Neni 7 i LPP-s Trajtimi i barabartë i O.E. pjesëmarrës

Neni 59 i LPP-s Vlerësimi i tenderit

Neni 3 i RROUP pika 3.12 Kërkesat për përdoruesit e sistemit të Prokurimit elektronik

Neni 41 i RROUP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te nderuar,

Sikur jeni në dijeni, ne kemi shprehur interesimin tonë për pjesëmarrje në tenderin në fjalë. Pasi kemi parë njoftimin për kontratë, kemi përgatitur dokumentacionin në mënyrë që ti plotësojmë kërkesat e paraqitura nga ana juaj në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Me datë 02.10.2020 përmes platformës elektronike, kemi dorëzuar ofertën tonë.

Pasi e kemi publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës, ne me datë 28.10.2020, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik. Nga ana juaj, kemi marrë dokumentacionin e grupit të Operatorëve Ekonomik të cilin e kemi shpërblyer me kontratë. Pas ekzaminimit të dokumentacionit të tyre, kemi vërejtur se ky grup i O.E. nuk është i përgjegjshëm sepse nuk e ka dorëzuar tenderit në formën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dosje të tenderit.

Nga formulari i paraqitjes së tenderit shihet qartë aplikimi në të cilin grupi ka paraqitur formularin e tenderit vetëm në emër të liderit të grupit "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K.

ndërsa, ju në njoftimin për dhënie të kontratës keni cekur se shperblehet me kontratë grupi i opertaorëve ekonomik "AAB CONSTRUCTION " SH.P.K. N.P.SH BAGERI" & AL-GROUP" SH.P.K. Ju si Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit keni kërkuar që në rast të krijimit të grupit të gjithë anëtarët duhet të jenë të regjistruar në platformën elektronike të KRPP-s dhe tenderi duhet të dorëzohet në grup, që nënkupton që tenderi të dorëzohet nga të gjithë anëtarët e grupit bashkarisht dhe jo vetëm nga lideri i grupit. (Shih: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) neni 11.1)

Platforma elektronike e KRPP-s e ka paraparë mundësinë e krijimit të grupit në të cilën duhet të cekën të gjithë anëtarët dhe ta krijojnë grupin në sistem të e-prokurimit, në mënyrë që grupi të pasqyrohet në të gjitha dokumentet e tenderit. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të cilin e kemi pranuar nga ana juaj, shihet në proceverbalin e hapjes tenderit, se është dorëzuar vetëm nga lideri, ndërsa në raportin e vlerësimit dhe vednimin për dhënie ju keni cekur se shpërbleni me kontratë grupin e operatorëve ekonomik.

Gjatë ekzaminimit të formularit të dorëzimit të tenderit ne kemi vërejtur edhe shkelje tjera të cilat janë bërë nga ana juaj. Sikur shihet nga certifikata e biznesit, "AAB Construction" SH.P.K. ka ndryshuar të dhënat e biznesit (Nr. e biznesit dhe nr. fiskal) por në platformën elektronike nuk i ka paraqitur ndryshimet. Neni 3 i RROUP pika 3.12 Kërkesat për përdoruesit e sistemit të Prokurimit elektronik, shprehimisht ka paraparë që: "Të gjithë Operatorët Ekonomik që janë të regjistruar dhe janë aktiv ne platformë të prokurimit elektronik, **për çfarëdo ndryshimi të të dhënave të biznesit në Agjencion për Regjistrim te Bizneseve (ARBK) dhe Administratë Tatimore (ATK), që për pasojë ka ndryshim/ndërrim të emërimit dhe numrit te fiskal/biznesit, janë të obliguar** që menjëherë vetë t'i përditësojnë të dhënat në platformë të prokurimit elektronik. Përditësimi i të dhënave bëhet në pajtim me udhëzimet e KRPP-së, nëpërmjet tavolinës ndihmëse ose udhëzuesit të publikuar në ëeb faqe të prokurimit elektronik."

Nga ato që u thanë më lartë, vijmë në përfundim që ju si autoritet kontraktues, keni shpallur fitues një tenderues i cili nuk i ka plotësuar kërkesa formale administrative. Duke vepruar kështu keni shkelur njërin nga parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP të përcaktuar në neni 41 i RROUP.

Gjatë vlerësimit të tenderit nuk e keni marrë parasysh kërkesën tuaj të cilën vetë e keni paraqitur në dosje të tenderit që në rast të krijimit të grupit, tenderi të dorëzohet në grup.

Ligji i Prokurimit Publik në nenin 59 dhe RROUP në nenin 41 ka paraparë që AK ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimi e tenderëve ta bëjë në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pra veprimi juaj është në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë andaj konsiderojmë që ju i keni shkelur këto dispozita gjatë vlerësimit të tenderit.

Shpërblimi i një operatori të pa përgjegjshëm me kontratë paraqet favorizim dhe në të njëjtën kohë diskriminim për operatorët e përgjegjshëm, andaj duke vepruar në këtë mënyrë konsiderojmë që keni bërë edhe shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Nga e tërë ajo që u tha më lartë, vijmë në përfundim se ju nuk e keni bërë një vlerësim të

drejtë dhe të pa anëshëm, prandaj kërkojmë që menjëherë të pezulloni procedurën e prokurimit, të rishqyrtoni vendimin tuaj për dhënie të kontratës duke e kthyer procesin në rivlerësim dhe të na shpërbleni neve me kontratë si të vetmin Operator Ekonomik të përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit, përndryshe jemi të detyruar që të bëjmë anëkesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Për përgatitjen e këtij tenderi janë bërë shpenzime të konsiderueshme. Gjithashtu shpërblimi me kontratë i një grupi të Operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm do të na pamundësojë fitimin e kësaj kontrate në të cilën kemi llogaritur shpenzimet mujore për punëtor dhe shpenzimet tjera si dhe fitimin për kryerjen e këtij projekti.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.